



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:072672

Datë: 23.02.2019

Numri i dokumentit: 00231723

P.nr.23/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, gjyqtari Sulltan Dobraj, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurës H. T., i akuzuar sipas PTH nga Peja me aktakuzë **PP/II.nr.2733/2018 te dt.10.01.2019**, për veprën penale lidhja e paautorizuar ne shërbime nga neni 321 par. 1 të KPRK-ës, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit fillestar me **dt.04.02.2019**, ne praninë e prokurores se shtetit Lumturje Vuçetaj dhe te pandehurës, me dt. 04.02.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.18.02.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura **H.T.** e lindur me dt. ..., e bija e A. dhe nënës N. e vajzërisë H., e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr...., posedon nr. tel.shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për arsye se:

Më datë 23.02.2017 në kohë të pacaktuar në shtëpinë e saj pa autorizim të furnizuesit është lidhur me rrjetin elektrik, në atë mënyrë që, e pandehura me datën e cekur me lartë nga ana e komisionit te autorizuar te 'K...' -it është hasur në një kabull 5x2.5mm jashtë njehsorit elektrik, ashtu që ne mënyre te paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike me pajisjet elektrike te cekura si ne procesverbalin nr.2372516 më ç 'rast te dëmtuarës i ka shkaktuar dëme materiale në shumë prej 216.21euro.

- **me çka ka kryer vepër penale “lidhja e paautorizuar ne shërbime” nga neni 321 të KPRK-ës.**

Andaj gjykata, bazë te neneve: 7, 17, 21, 41, 45, 46, 51, 73 te KPK-ës, nenit **321** te KPRK-së dhe neneve 365 dhe 453 paragraf 1 të KPP-ës, të akuzuarin e:

G J Y K O N ME DËNM NE KUSHT

- I. I shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **30 (tridhjetë) ditë**, të cilin dënim fare **nuk do ta mbaj**, nëse në afat **prej (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
- II. Te pandehurës gjykata i **shqipton edhe dënimin me gjobë ne shumë prej 300 (treqind) euro**, te cilin dënim e pandehura fare **nuk do ta paguan**, nëse në afat **prej 1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër të re penale
- III. Gjkata mund ta revokoj dënimin me kusht nëse i dënuari gjate kohës se verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale
- IV. Obligohet e pandehura te kompensoi dëmin ndaj te dëmtuarës ne shumë prej 216.21euro.
- V. E pandehura lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë me aktakuzën **PP/II.nr.2733/2018 te dt.10.01.2019**,, ka akuzuar të pandehurën H.T. për veprën penale lidhja e paautorizuar ne shërbime nga neni 321 të KPRK-ës, ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtës të administrohen provat e duhura e më në fund e njëjta të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjkata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt. 04.02.2019 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit te aktakuzës e pandehura e ka pranuar fajësinë, të cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit fillestar konform nenit 248 paragraf 4 te KPP-ës.

Prokurori Themelore ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se : me pranimin e fajësisë e ky pranim i fajësisë mbështetet me provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lendes unë ne tersi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik te saj gjykatës i propozoi që i njëjti të shpallet fajtor dhe ta dënohet sipas ligjit lidhur me vendimin për dënim si rrethana lehtësuese te merre pranimin e fajësisë, mosha e saj e shtyrë dhe premtimi qe do ta kompensoi demin.

E pandehura deklaroi se: shprehi keqardhje, jam shumë e penduar, dhe premtoi se në të ardhmen do të jem më e kujdesshme dhe do ta kompensoi demin.

Gjykata me pranimin e fajësisë në tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Me datë 23.02.2017 në kohë të pacaktuar në shtëpinë e saj pa autorizim të furnizuesit është lidhur me rrjetin elektrik, në atë mënyrë që, e pandehura me datën e cekur me lartë nga ana e komisionit të autorizuar të 'K...' -it është hasur në një kabull 5x2.5mm jashtë njehsorit elektrik, ashtu që në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike me pajisjet elektrike të cekura si në procesverbalin nr.2372516 më ç 'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëme materiale në shumë prej 216.21euro.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë e pandehura e cila i ka pasur të njohura natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në kuptim të nenit 257 të KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë konform nenit 248 të KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurës janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës të lidhjes së paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-ës, ka konstatuar se e pandehura ka qenë e vetëdijshme për veprimet e ndërmarrja, i ka dashur ato veprime dhe pasojën e shkaktuar e ka dëshiruar, për veprimet e tilla të cilat përmbushen elementet e veprës penale të lartcekur, është përgjegjëse dhe e përgjegjshme, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurën e shpall fajtoreshë për këtë veprë penale, i ka shqiptuar dënimin me kusht me burgim dhe me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit që parashihet në nenin 41 të KPRK-ës, si mase për parandalimin e të pandehurës por edhe si mase për parandalimin e të pandehurës dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurës. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se e pandehura e ka pranuar fajësinë, sjelljet e mira gjatë gjykimit, pastaj kërkim falje nga ana e të pandehurës, ka qenë hera e parë që ka ra ndesh me ligjin ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPPK-ës e ka obliguar të pandehurën ta kompensoi dëmin ndaj te dëmtuarës 'K...' në shumë prej 216.21euro, sepse me pranimin e fajësisë gjykata konsideron se e ka pohuar edhe dëmin e shkaktuar.

Në bazë të nenit 453 të KPRK-ës gjykata te pandehurën e ka liruar nga shpenzimet e procedurës penale për shkak te gjendjes se dobët ekonomike sepse nëse obligohet në pagesën e shpenzimeve atëherë do te rrezikohet edhe me tej gjendja materiale e të pandehurës ose të personave që ajo detyrohet ti mbështesë materialisht.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.23/2019 me dt.18.02.2019**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e pranimin te kopjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës se Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore Pejë dega ne Deçan.